



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2024-03

Vendosi: Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 18 shtator 2024

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

**Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Urdhër drejtuar Shalës për Ridorëzimin e
Njoftimit për Apel**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave:
Sajmon Loz

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim mocionin e dorëzuar më 9 shtator 2024 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (përkatësisht, “Mocioni” dhe “ZPS-ja”).² Zoti Pjetër Shala (“Shala” ose “i akuzuari” ose “Mbrojtja”) u përgjigj më 13 shtator 2024.³ ZPS-ja nuk u kundërpërgjigj.

1. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykses lëshoi aktgjykimin (“Aktgjykimi”), ku e shpalli Shalën fajtor për tri pika të Aktakuzës dhe të pafajshëm për njëren pikë dhe e dënoi me 18 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁴

¹ F00011, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 3 shtator 2024 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 4 shtator 2024).

² F00013, Kërkesë e Prokurorisë për Urdhër Drejtuar Mbrojtjes së Shalës për Ridorëzimin e Njoftimit të Tij për Apel, 9 shtator 2024 (konfidencial) (“Mocioni”). Më 10 shtator 2024, Paneli ndryshoi, *proprio motu*, afatet për dorëzimin e parashtrimeve dhe urdhëroi Shalën të dorëzonte përgjigjen, nëse kishte, deri më 13 shtator 2024, ora 12:00 dhe ZPS-në të dorëzonte kundërpërgjigjen, nëse kishte, deri më 16 shtator 2024, ora 16:00. Shih CRSPD3, [CA-2024-03] F00013 – Urdhër i Panelit të Apelit në lidhje me Kalendarin e Parashtrimeve, 10 shtator 2024 (konfidencial).

³ F00014, Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Urdhër për Ridorëzimin e Njoftimit për Apel të Mbrojtjes, 13 shtator 2024 (konfidencial) (“Përgjigjja”).

⁴ KSC-BC-2020-04, F00847, Aktgjykim dhe Dënim, 16 korrik 2024 (konfidencial) (“Aktgjykimi”), para. 1121-1125; KSC-BC-2020-04, F00107/A01, Version i redaktuar publik i Aktakuzës së Korrigjuar, 16 nëntor 2021; KSC-BC-2020-04, F00098/A01, Aktakuza e Korrigjuar, 1 nëntor 2021 (konfidencial) (“Aktakuza”). Trupi Gjykses e dënoi Shalën për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës dhe e shpalli të pafajshëm për trajtim mizor si krim lufte sipas pikës 2 të Aktakuzës. Shih Aktgjykimin, para. 1124. Shih edhe KSC-BC-2020-04, F00843, Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Aktgjykimit, 9 korrik 2024.

2. Më 24 korrik 2024, Paneli i Apelit miratoi pjesërisht kërkesën e të akuzuarit për zgjatjen e afatit për dorëzimin e njoftimit për apel kundër Aktgjykimit (“Njoftimi për Apel”).⁵ Më 2 shtator 2024, i akuzuari dorëzoi Njoftimin për Apel.⁶

3. ZPS-ja kërkon që Paneli të hedhë poshtë Njoftimin për Apel dhe të urdhërojë Mbrojtjen ta ridorëzojë atë, sepse nuk përmbush kërkesat e nenit 47(1) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara.⁷ Në mbështetje të kërkesës së saj, ZPS-ja parashtron se disa prej pikave të apelit nuk specifikojnë qartë gabimin e pretenduar,⁸ dhe/ose saktë masën ndreqëse të kërkuar.⁹ ZPS-ja gjithashtu parashtron se i gjithë objekti i Njoftimit për Apel është i paqartë.¹⁰

4. Shala përgjigjet se Njoftimi për Apel është në përputhje me nenin 47(1) të Udhëzuesit të Punës,¹¹ dhe se Mocioni duhet të hidhet poshtë.¹² Shala nuk paraqet argumente për ndonjë pikë specifike të Njoftimit për Apel, por pretendon se gabimet që Mbrojtja synon të demonstrojë, si dhe lloji i tyre dhe argumentet përkatëse janë paraqitur në mënyrë të mjaftueshme.¹³ Shala është gjithashtu i mendimit se e ka specifikuar qartë masën ndreqëse që kërkon.¹⁴ Sa i përket Njoftimit për Apel, Shala argumenton se ZPS-ja do të marrë hollësi të mëtjeshme dhe arsyetimin e shtjelluar në

⁵ F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 19 korrik 2024; F00006, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 24 korrik 2024. Më 8 gusht 2024, Paneli i Apelit hodhi poshtë një kërkesë tjetër nga Shala për ndryshimin e mëtjeshëm të afatit për dorëzimin e njoftimit për apel dhe konfirmoi se palët duhet të dorëzonin njoftimet për apel, nëse kishin, deri më 2 shtator 2024. Shih F00009, Vendim mbi Kërkesën e Mëtjeshme të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 8 gusht 2024, para. 8. Shih gjithashtu F00008, Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatje të Mëtjeshme të Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 7 gusht 2024.

⁶ F00010, Njoftimi për Apel i Mbrojtjes, 2 shtator 2024 (konfidencial) (“Njoftimi për Apel”).

⁷ Mocioni, para. 1, 8, 10. ZPS-ja i referohet KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës”).

⁸ Mocioni, para. 2, 4.

⁹ Mocioni, para. 2, 5.

¹⁰ Mocioni, para. 2, 6-7.

¹¹ Përgjigja, para 9, 14.

¹² Përgjigja, f. 5.

¹³ Përgjigja, para. 10.

¹⁴ Përgjigja, para. 11.

mënyrë të plotë në dosjen e apelit të Mbrojtjes dhe se do të ketë mundësinë të kundërshtojë argumentet e Mbrojtjes në dosjen e përgjigjes së vet.¹⁵ Shala gjithashtu argumenton se kërkesa e ZPS-së përbën shkelje të procesit.¹⁶

5. Sipas nenit 47(1)(b) të Udhëzuesit të Punës, njoftimi për apel duhet të specifikojë me hollësi për secilën arsye: “(1) gabimin e pretenduar ligjor që e bën të pavlefshëm aktgjykimin, gabimin e pretenduar faktik që ka shkaktuar gabim gjyqësor dhe/ose gabimin e pretenduar në përcaktimin e dënimit; (2) konstatimin ose vendimin në aktgjykimin të apeluar, duke përmendur konkretisht numrin e faqes dhe/ose paragrafit përkatës; (3) çfarëdo vendimi tjetër të apeluar, duke përmendur konkretisht datën e parashtrimit për protokollim, numrin e faqes dhe paragrafit dhe/ose numrin e faqes së transkriptit; dhe (4) masën konkrete ndreqëse që kërkohet”.¹⁷ Neni 47(1)(c) i Udhëzuesit të Punës kërkon që njoftimi për apel të identifikojë masën e përgjithshme ndreqëse që kërkohet.¹⁸

6. Që në fillim, Paneli pajtohet se, ashtu siç sugjerohet edhe nga Mbrojtja, ZPS-ja duhet ta ketë të qartë se do t'i marrë pikat e apeluara të shtjelluara në mënyrë të plotë në dosjen e apelit të Mbrojtjes.¹⁹ Megjithatë, Paneli e vlerëson të pabazuar pretendimin e Shalës se Mocioni është shkelje e procesit – mbi bazën se ZPS-ja keqinterpreton Udhëzuesin e Punës kur sugjeron, sipas Mbrojtjes, se njoftimi për apel i Mbrojtjes duhet të miratohet nga ZPS-ja – dhe, rrjedhimisht, nuk do ta shqyrtojë atë më tej.²⁰ Paneli rikujton se në njoftimin për apel nuk është e nevojshme të shtjellohen me hollësi argumentet që palët kanë ndër mend të përdorin për të mbështetur pikat e apelit, pasi

¹⁵ Përgjigja, para. 12-13.

¹⁶ Përgjigja, para. 14.

¹⁷ Neni 47(1)(b) i Udhëzuesit të Punës. Shih edhe KSC-CA-2022-01, F00021, Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Dosjes së Apelit dhe Kërkesën e ZPS-së për Urdhër për Ridorëzimin e Njoftimit për Apel të Haradinajt, 1 korrik 2022, para. 10.

¹⁸ Neni 47(1)(c) i Udhëzuesit të Punës.

¹⁹ Përgjigja, para. 12.

²⁰ Shih Përgjigjen, para. 14.

kjo bëhet në dosjet e apelit.²¹ Megjithatë, kjo nuk e çliron të akuzuarin nga detyrimi për të respektuar Udhëzuesin e Punës. Udhëzuesi i Punës është krijuar për të trajtuar aspekte të hollësishme të procesit para Dhomave të Specializuara dhe për të rregulluar formën dhe përmbajtjen e parashtrimeve me shkrim. Nëse njoftimit i mungon qartësia dhe saktësia, ai nuk përmbush qëllimin e njoftimit të apelit.²²

7. Sa u përket argumenteve të ngritura në Mocion, ZPS-ja argumenton se, në lidhje me pikat 1, 3, 5, 6, 8, 9, 13 dhe 14, Njoftimi për Apel nuk specifikon qartë gabimin e pretenduar,²³ dhe se, me përjashtim të pikave 5, 11 dhe 14, Njoftimi për Apel nuk specifikon saktë masën ndreqëse të kërkuar në lidhje me secilën pikë.²⁴

8. Paneli vëren se, në hyrje të Njoftimit për Apel, Shala pretendon se secila prej 14 pikave të apelit paraqitur në të "ose e bën të pavlefshëm Aktgjykimin e Kundërshtuar, ose ka çuar në vendim gjyqësor të gabuar".²⁵ Në pjesën e fundit të Njoftimit për Apel në lidhje me masën e përgjithshme ndreqëse të kërkuar, Shala më tej u referohet edhe "gabimeve juridike, faktike dhe gabimeve në dhënien e dënimit" që ndikuan në Aktgjykim.²⁶

²¹ Shih IRMCT, *Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, MICT-15-96-A, Decision on Jovica Stanišić's Motion to Strike and/or Amend Prosecution Notice of Appeal and on a Request to Expedite, 1 October 2021, p. 3; ICTY, *In the Case Against Florence Hartmann*, IT-02-54-R77.5-A, Decision on Motions to Strike and Requests to Exceed Word Limit, 6 November 2009 ("*Hartmann Decision*"), para. 14; ICTY, *Prosecutor v. Mrkšić and Šljivančanin*, IT-95-13/1-A, Decision on the Prosecution's Motion to Order Veselin Šljivančanin to Seek Leave to File an Amended Notice of Appeal and to Strike New Grounds Contained in his Appeal Brief, 25 August 2008, para. 8 dhe jurisprudenca e cituar aty; ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-992-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Gbagbo against the decision of Trial Chamber I of 10 March 2017 entitled "Decision on Mr Gbagbo's Detention", 19 July 2017, para. 19; ECCC, *Prosecutor v. Nuon and Khieu*, 002/19-09-2007/ECCC/SC, Decision on Defence Motion for Extension of Time and Page Limits on Notices of Appeal and Appeal Briefs, 29 August 2014, para. 8.

²² ICTR, *Niyitegeka v. Prosecutor*, ICTR-96-14-A, Decision on Prosecution Motion Concerning Defects in the Appellant's Notice of Appeal, 26 September 2003, p. 3.

²³ Mocioni, para. 2, 4.

²⁴ Mocioni, para. 2, 5.

²⁵ Njoftimi për Apel, para. 1, poshtëshënimi 2. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 11, poshtëshënimi 12.

²⁶ Njoftimi për Apel, para. 42.

9. Paneli konstaton se këto referenca janë të pamjaftueshme dhe udhëzon Shalën të specifikojë natyrën e gabimit të pretenduar në lidhje me pikat 1, 3, 5 dhe 13 me qëllim respektimin e nenit 47(1)(b)(1) të Udhëzuesit të Punës që kërkon specifikimin nga pala me hollësi të llojit të gabimit të pretenduar në lidhje me secilën pikë të apelit. Paneli gjithashtu rikujton se formulimet alternative/kumulative për gabimet juridike të pretenduara dhe gabimet faktike të pretenduara mund të përdoren vetëm në rastet kur aspektet juridike dhe faktike janë vërtet të pandashme dhe ekziston një paqartësi reale.²⁷ Megjithatë, në kundërshtim me argumentin e ZPS-së, Paneli gjykon se Shala e specifikon mjaftueshëm llojin e gabimit që pretendon të jetë bërë në lidhje me pikat 6, 8, 9 dhe 14.²⁸

10. Paneli gjithashtu pajtohet me ZPS-në se, me përjashtim të pikave 5, 11 dhe 14, Njoftimi për Apel nuk specifikon saktë masën ndreqëse të kërkuar lidhur me secilën pikë të apelit. Pretendimi i përgjithshëm i të akuzuarit se Paneli i Apelit duhet të “shfuqizojë dënimin e dhënë nga Trupi Gjykues dhe/ose ta kthejë çështjen për rigjykim dhe/ose të vendosë, nëse është e nevojshme, dënimin e duhur”²⁹ është tepër i përgjithshëm dhe lidhet me kriterin e përcaktuar në nenin 47(1)(c) të Udhëzuesit të Punës, sipas të cilit, njoftimi për apel duhet të identifikojë masën e përgjithshme ndreqëse të kërkuar. Megjithatë, “masa e përgjithshme ndreqëse që kërkohet” është e ndryshme nga ajo çka kërkon neni 47(1)(b)(4) i Udhëzuesit të Punës, sipas të cilit njoftimi duhet të specifikojë qartë “masën konkrete ndreqëse që kërkohet” për secilën pikë.³⁰

²⁷ Shih p.sh. Vendimin *Hartmann*, para. 13.

²⁸ Në pikën 8 pretendohet për gabime juridike dhe faktike. Shih Njoftimin për Apel, para. 17-19. Në pikën 14 pretendohet për gabime juridike dhe gabime në dhënien e dënimin. Shih Njoftimin për Apel, “Pika 14: Gabime në dhënien e dënimin”. Shih gjithashtu Njoftimin për Apel, para. 38-40. Në pikat 6 dhe 9 pretendohet për keqpërdorim të diskrecionit.

²⁹ Njoftimi për Apel, para. 42. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 11.

³⁰ *Krahaso* nenin 47(1)(c) të Udhëzuesit të Punës me nenin 47(1)(b)(4) të Udhëzuesit të Punës. Shih gjithashtu Vendimin *Hartmann*, para. 13 (ku Dhoma e Apelit e TPNJ-së vlerësoi se apeluesja e kishte përmbushur këtë kërkesë, duke u shprehur se “secili prej gabimeve të pretenduara të Dhomës së Gjyimit, nëse do të pranohej nga Dhoma e Apelit, do të çonte në rrëzimin e dënimin të saj”).

11. Rrjedhimisht, Paneli udhëzon të akuzuarin të rishikojë formulimin e pikave 1-4, 6-10, 12 dhe 13 me qëllim respektimin e nenit 47(1)(b)(4) të Udhëzuesit të Punës, i cili kërkon që apeluesi të specifikojë saktësisht masën ndreqëse të kërkuar në lidhje me secilën pikë.

12. Sa i përket kuadrit të Njoftimit për Apel, në lidhje me pikat 1, 4, 6-9, 12-14, ZPS-ja pretendon se është ai i paqartë, pasi këto pika të apelit përfshijnë një numër nënpikash që nuk lidhen me njëra-tjetrën dhe me pikën e përgjithshme nën të cilën janë paraqitur.³¹ Megjithëse ZPS-ja argumenton se janë disa pika të apelit që janë të paqarta, ajo shtjellon argumentin e saj vetëm në lidhje me pikën 8.³²

13. Paneli vlerëson se nuk është e pazakontë që në apel të paraqiten argumente që kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara të të drejtave për gjykim të drejtë, përfshirë edhe pretendime se trupi gjykues i shkallës më të ulët përmbysi detyrimin e vërtetimit.³³ Paneli vlerëson se parashtrime të tilla lejohen. Megjithatë, Paneli rikujton se aftësia e tij për të shqyrtuar argumentet e një pale varet nga sa të qarta, logjike dhe shteruese janë argumentet e paraqitura nga ajo palë.³⁴ Argumentet e paraqitura në mënyrë të fragmentuar, pa demonstruar asnjë gabim juridik apo faktik rrezikojnë të hidhen poshtë menjëherë.³⁵ Gjithashtu, Paneli rikujton se njoftimi për apel duhet “ta përqendrojë vëmendjen palës tjetër, që nga dita e dorëzimit të njoftimit për apel, tek argumentet që do të shtjellohen më pas në dosjen e Apelit”.³⁶

14. Në këtë rast, Paneli i Apelit konstaton se pika 8 është vërtet e paqartë. Në veçanti, paragrafët 17 dhe 20 të Njoftimit për Apel përmbajnë parashtrime shumë të

³¹ Mocioni, para. 2, 6. Shih gjithashtu Mocionin, para. 6, poshtëshënimi 14.

³² Mocioni, para. 7.

³³ Shih p.sh. KSC-CA-2022-01, F00114, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023 (“Aktgjykimi i Apelit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj”), para. 44-58.

³⁴ KSC-CA-2023-02, F00038, Prokurorja e Specializuar k. Salih Mustafës, Aktgjykim i Apelit, 14 dhjetor 2023, para. 29; Aktgjykimi i Apelit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 29.

³⁵ Aktgjykimi i Apelit në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 45.

³⁶ TPNJ, Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit, IT-04-82-A, Aktgjykimi, 19 maj 2010, para. 246.

përgjithshme që nuk duken se lidhen me njëri-tjetrin dhe disa prej janë të njëjta me ato të paraqitura për pika të tjera. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se Pika 8 nuk e informon mjaftueshëm ZPS-në lidhur me objektin e apelit³⁷ dhe udhëzon Shalën të qartësojë thelbin e kësaj pike të apelit, në qoftë se dëshiron të vazhdojë ta mbajë këtë pikë.

15. Së fundi, Paneli vë në dukje se Njoftimi për Apel përbëhet nga 3689 fjalë dhe nuk është në përputhje me nenin 47(2) të Udhëzuesit të Punës, sipas të cilit “njoftimi për apel parashtruar në bazë të rregullës 176 dhe rregullës 186(3) të Rregullores nuk duhet të jetë më shumë se 3.000 fjalë”.³⁸ Shala ishte në dijeni të këtij kriteri, sepse në poshtëshënimin 1 të Njoftimit për Apel, kërkoi “shtim të numrit të lejuar të fjalëve me një numër të kufizuar prej 690 fjalësh” me qëllim “paraqitjen e një njoftimi të plotë për apel”.³⁹ Megjithatë, Paneli rikujton se neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton se palët në proces mund të kërkojnë, *mjaftueshmërisht në kohë*, shtim të numrit të lejuar të fjalëve duke vërtetuar se ka *arsye bindëse* që përbëjnë rrethana të posaçme.⁴⁰ Në rastin në fjalë, Paneli konstaton se Shala nuk e përmbush këtë dispozitë, as sa i përket afatit, as sa i përket arsyetimit të kërkesës. Gjithashtu, Paneli gjykon se, në kundërshtim me atë që parashtron Shala, kjo përbën tejkallim të konsiderueshëm të 3.000 fjalëve të lejuara. Në këto rrethana, Paneli gjykon se ky ndryshim i numrit të lejuar të fjalëve nuk përligjet dhe e refuzon atë. Sidoqoftë, duke bërë një përjashtim, Paneli e gjykon me vend të miratojë shtimin me 200 fjalë të numrit të lejuar të fjalëve për t’i lejuar Shalës të zbatojë udhëzimet e dhëna në këtë Vendim. Rrjedhimisht, Paneli udhëzon

³⁷ Shih Vendimin *Hartmann*, para. 12: “Dhoma e Apelit rikujton se qëllimi i paraqitjes së arsyeve për apel nga pala apeluesi është që pala e paditur të njoftohet për arsyet e apelit që në momentin e dorëzimit të njoftimit për apel”.

³⁸ Paneli vë në dukje se, në mbështetje të kërkesës së saj që Paneli të urdhërojë Mbrojtjen të dorëzojë një njoftim të përditësuar, ZPS-ja parashtron se Njoftimi për Apel nuk i përmbahet nenit 47(2) të Udhëzuesit të Punës, sepse tejkalon kufizimin prej 3.000 fjalësh, por nuk e shtjellon më tej këtë argument. Shih Mocionin, poshtëshënimi 5.

³⁹ Njoftimi për Apel, para. 1, poshtëshënimi 1. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 15, ku Shala parashtron se shtimi i numrit të lejuar të fjalëve që kërkoi “është absolutisht i nevojshëm që Mbrojtja të japë njoftim të mjaftueshëm për provat e saj”.

⁴⁰ Theksimi i shtuar.

Shalën të dorëzojë një version të ndryshuar të këtij Njoftimi për Apel, me jo më shumë se 3,200 fjalë.

16. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON Mocionin pjesërisht;

URDHËRON Shalën të dorëzojë një njoftim të ndryshuar për apel prej jo më shumë se 3,200 fjalësh, në përputhje me udhëzimet e dhëna në paragrafët 9, 10, 11, 14 dhe 15 të këtij Vendimi, jo më vonë se dhjetë ditë nga data e marrjes së këtij Vendimi; dhe

SQARON se, si rrjedhojë e këtij Vendimi, ndryshohet afati për dorëzimin e dosjes së apelit siç specifikohet në rregullën 179(1) të Rregullores dhe se dosja e apelit e Shalës duhet të dorëzohet dhjetë ditë pas afatit fillestar, konkretisht deri më 14 nëntor 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E mërkurë, 18 shtator 2024

Në Hagë, Holandë.